



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Integritime Evropiane
Mbledhja nr. 32
Prishtinë, më 25. 03. 2009, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL
I mbledhjes së Komisionit për Integritime Evropiane

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Bujar Bukoshi, Džezair Murati, Hydajet Hyseni, Edita Tahiri, Sabri Hamiti, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini, Nait Hasani, Naser Rugova dhe Branislav Grbić, ndërsa mungoi Edita Tahiri.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Takim me përfaqësuesit e Organizatës Joqeveritare Qendra Rinore nga Peja;
3. Miratimi i rekomandimeve të dala nga tryeza e rrumbullakët;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues, jonizues dhe siguria nukleare, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për partneritetet publike-private dhe koncesionet e sigurimit të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike dhe procedurat për dhënien e tyre, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit për Protokollin shtetëror të Republikës së Kosovës me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Takim me përfaqësuesit e Organizatës Joqeveritare Qendra Rinore nga Peja

Kryesuesja - I falënderoi përfaqësuesit e OJQ-së Qendra Rinore që kanë shprehur interesim të informohen për punën e Komisionit për Integritime. E hapi diskutimin.

Engelbert Zefaj tha jemi një grup i të rinjve nga Peja dhe në ekipin tonë ka përfaqësues të shoqërisë civile, si dhe studentë të fakulteteve të cilët funksionojnë në Pejë. Shtoi së bashku jemi bërë pjesë e projektit, të cilin e kemi quajtur "Me rininë drejt Evropës". Projekti ka për qëllim t'i njoftojë të rinjtë për proceset integruese evropiane, për rëndësinë e tyre, si dhe për vlerat evropiane. Ky projekt përkrahet nga organizata GTZ dhe tani është në fazën përfundimtare. Sa u përket aktiviteteve tona, si organizatë joqeveritare, deri më tani tha kemi organizuar konferenca dhe debate, fushata vetëdijesimi dhe takime me nxënësit e shkollave të mesme. Sa i përket integritit të Kosovës në BE, vendi ynë gjithnjë ka shprehur simpati për vendet evropiane dhe për botën Perëndimore, si dhe dëshirën që një ditë të bëhet pjesë e BE-së. Fakti se Kuvendi i Kosovës ka themeluar Komisionin Parlamentar për Integritet Evropian tregon sa e përkushtuar është shoqëria Kosovare në këtë drejtim. Kemi përshtypje se opinioni kosovar shumë pak është i njoftuar për këtë Komision, për punën e tij dhe për progresin që ju keni bërë. Shtoi shpresojmë që sot të arrijmë të kuptojmë, sado pak, rreth pikës deri ku ka arritur Kosova në rrugën drejt integriteteve evropiane, cilat janë sfida kryesore dhe cila është dinamika dhe agjenda e Komisionit për Integritet Evropian. Siguroj se informatat që do t'i marrim sot, do të kalojnë te një grup i të rinjve dhe të pjesëtarëve të shoqërisë civile, të cilët shumë shpejt do të arrijnë t'i shpërndajnë këto informata në komunën e Pejës. Kështu do të kontribuojnë sado pak në drejtim të procesit të integriteteve evropiane.

Fatmir Rexhepi e përshëndeti këtë formë të komunikimit. Shtoi ne jemi brezi i cili kemi punuar për pavarësimin e vendit, ndërsa ju jeni brezi i integritit të vendit, andaj nuk ka dyshim se edukimi është prioritet i juaji.

Kryesuesja tha nga viti 2000, në samitet e mbajtura në Fier dhe Zagreb, u konfirmua perspektiva evropiane për Ballkanin Perëndimor. Aty është përfshirë edhe Kosova. Shtoi kjo është rikonfirmuar edhe në Samitin e Selanikut në vitin 2003. Po ashtu është rikonfirmuar edhe sivjet nga ana e përfaqësuesit të zgjerimit të BE-së, Oli Rehn, se Kosova e ka vendin në Evropë. Në vitin 2002 BE-ja krijoi një mekanizëm përcjellës, i cili quhet mekanizëm përcjellës i stabilizim-asociimit, në të cilin Kosova pas pavarësimit çdo herë e më shumë do të jetë e pranishme. BE-ja ka interes ta integrojë edhe Kosovën në BE për arsye strategjike, të sigurisë, të lëvizjes së lirë të njerëzve, si dhe të prosperitetit ekonomik. Njëherësh tha të gjitha këto qëllime të BE-së janë edhe të mira, edhe interes i Kosovës. Njoftoi se në dokumentin e fundit që ka të bëjë me liberalizimin e vizave Kosova nuk është përfshirë fare në atë listë, por tha me punë dhe me angazhim më të madh besoj se do të përfshihemi edhe ne. Kërkohej që çdo shtet, i cili synon të integrohet në BE, duhet t'i plotësojë kriteret e Kopenhagës. Me qëllim të angazhimit sa më të madh të institucioneve të Kosovës, drejt integritit të Kosovës në BE, është krijuar Agjencia për Integritet Evropian, ndërsa Kuvendi i Kosovës ka themeluar Komisionin për Integritet Evropian. I njoftoj për fushëveprimtarinë e Komisionit. Shtoi se në fushën e përafrimit të legjisllacionit me *Acquis Communautaire* me ndihmën e UNDP-së ishte i angazhuar një ekspert, i cili ka ndihmuar Komisionin në këtë drejtim, ndërsa tash e tutje me ndihmën e TAIX-it, Komisioni Evropian do ta angazhojë një ekspert për t'i ndihmuar Komisionit në fushën e përafrimit të legjisllacionit. Sa i përket mbikëqyrjes së punës së Qeverisë në raport me Planin e veprimit për integritet evropian dhe me Planin e veprimit tha i ftojme ministrat, si dhe zv.kryeministrin e caktuar për integritet evropian që të raportojë para Komisionit. Sa i përket diplomacisë parlamentare tha kemi kontakte të përhershme me të gjitha institucionet e BE-së që veprojnë në Kosovë. Po ashtu kemi realizuar vizita në kuvendet e Kroacisë dhe të Shqipërisë që të njoftohemi për së afërmi për rrugën e tyre drejt integriteteve. Njoftoi se është realizuar edhe një vizitë në Parlamentin Evropian. Për herë të parë është debatuar në seancë Raporti i Progresit i Komisionit Evropian dhe nga ai debat Komisioni për Integritet është autorizuar ta përgatitë Planin e veprimit për partneritet evropian, duke u bazuar në sfidat që dalin nga Raporti i Progresit. Komisioni po ashtu ka hartuar edhe një rezolutë, me të cilën shpreh gatishmërinë që të marrë veprime konkrete. Sipas Planit të veprimit është hartuar edhe Plani i punës së Komisionit. Tash e tutje

Komisioni për Integritet Evropian do të raportojë çdo tre muaj në seancë plenare për përmbushjen e Planit të veprimit.

Flora Nikçi pyeti çka përfshihet në sfidat e identifikuar në Raportin e Progresit dhe në bazë të të cilave është hartuar Plani i veprimit.

Naser Rugova tha Parlamenti Evropian është organi më i lartë legjislativ i mekanizmave të Bashkimit Evropian, pas tij është Këshilli i Ministrave i Bashkimit Evropian, që mbledhet në nivel të kryeministrave ose në nivel ministrash të punëve të jashtme, kurse Komisioni Evropian është pjesa teknokratike, që i studion, i elaboron dhe u jep rekomandime këtyre dy institucioneve më të larta. Shtoi në Komisionin Evropian është desku për Kosovën, i cili merret vetëm me zhvillimet në Kosovë dhe me sfidat që dalin për secilin vend. Sa u përket sfidave ato dalin nga objektivat politike, ekonomike dhe nga standardet evropiane. Ndër kriteret politike tha janë respektimi i të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve, që paraqesin sfidë e cila po na përçjell që dhjetë vjet. Pati vërejtje për funksionimin e rendit dhe të fuqizimit të shtetit ligjor. Sa u përket objektivave të ekonomisë pati vërejtje për menaxhimin e ndërmarrjeve publike, për politizimin e bordeve dhe për mosreformimin adekuat të administratës publike. Pati edhe sa i përket krimit të organizuar, ekonomisë joformale, trysnisë politike në media, si dhe për mosefikasitetin e gjyqësorit. Sa u përket politikave sektoriale pati vërejtje konkrete të përpunuara në mënyrë strukturale në Planin e veprimit. Tha ekziston konsensus kombëtar sa i përket procesit të integritetit Po ashtu kishte konsensus të plotë edhe brenda Komisionit. Shtoi marrëveshja e CEFT-ës është nënshkruar nga përfaqësues të UNMIK-ut. Tani ka shkelje flagrante të saj. Sa i përket liberalizimit të vizave tha do të kemi rol më aktiv që t'i bëjmë trysni më të madhe për qarkullim sa më të madh të të njerëzve dhe të mallrave. Ka angazhim të shtuar të të gjitha institucioneve të Kosovës për integritet evropianeve.

Bujar Bukoshi tha e ndiej të nevojshme ta sqaroj këtë çështje. 110 sfidat janë probleme të cilat janë rezultat i defekteve, i të metave të njerëzve tanë, por ne duhet të ballafaqohemi me to. Jemi shumë të angazhuar për zgjidhjen e tyre dhe vetëm me angazhimin tonë të përgjithshëm mund t'i zgjidhim. Edhe sikur të ishim të gjithë të përkryer, nëse nuk ka ekonomi, do të ishte i kotë i gjithë angazhimi ynë.

Edis Prapashtica pyeti pse nuk ndiqet praktika e Shqipërisë për themelimin e Ministrisë së Integritet Evropian?

Kryesuesja tha në një vizite që kishim në Shqipëri, në Ministrinë e Integritet Evropian, në pyetjen se a duhet që edhe Kosova ta themelojë Ministrinë e Integritet Evropian, na preferuan që për çështje praktike do të ishte më mirë të mos themelohet kjo ministri, sepse ngrihet një shkallë më lart se ministrinë e tjera.

Blerim Lika pyeti a është nënshkruar ndonjë marrëveshje me BE-në, sado e vogël që do të ishte?

Naser Rugova tha nga 27 shtetet anëtare të BE, 5 shtete nuk na kanë pranuar. Shtoi analizat e fundit tregojnë se Kosova është në stadin më të ulët. Kjo është bërë për arsye se nuk na kanë njohur edhe pesë shtete. Edhe po t'i përmbushnim të gjitha kriteret, të cilat kërkohen, për këtë arsye, nuk do të mund të anëtarësoheshim. Por as ne tha nuk jemi në nivel të detyrës.

Naser Lajqi pyeti çka mund të bëjmë për të ndihmuar në procesin e integritet Evropian? A mund të integrohemi në punën tuaj drejt integritet Evropian?

Bujar Bukoshi tha ka papunësi. Njerëzit me të drejtë kërkojnë të gjejnë rrugëdalje. Qeveria është bërë si byro e punësimit. Fakti se keni ardhur këtu tregon se jeni të motivuar të punoni.

Shtoi do ta shqyrtojmë mundësinë të kemi bashkëpunim sa më të madh me ju dhe të bëjmë përzgjedhje ndër të gjithë të rinjtë e angazhuar për integritime.

Kryesuesja tha vetë fakti se keni marrë përsipër ta njoftoni shoqërinë për punën tonë është një plus për ne. Shtoi pa na njohur të gjitha shtetet anëtare të BE, nuk mund të anëtarësohemi. Kërkoj nga të gjithë të punojmë sa më shumë.

Naser Rugova ju propozoi të kërkojnë një takim pune me kryetarin e komunës së Pejës që të japë përgjigje se çka do të bëjë për pikat e Raportit të Progresit, sepse kanë kaluar 3 muaj. Dhe ky do të jetë presion pozitiv nga ana juaj.

Dzezair Murati tha në Raportin e Progresit, ndër kritikën kryesore, është integrimi i minoriteteve. Njoftoi se janë disa rekomandime, të cilat i ka përgatitur Komisioni për Integritime Evropiane, me të cilat përpiqemi që komuniteteve t'u krijojmë kushte sa më të mira për integritim. Për t'u bërë shoqëri sa më demokratike, komunitetet duhet t'i gëzojnë të gjitha të drejtat, të cilat u garantohen me Konventën e Gjenevës. Disa komunitete, të cilat unë i përfaqësoj, tha bëjnë shumë përpjekje që sa më me sukses të integrohen në shoqërinë kosovare. Shtoi jam i informuar shumë saktë se në Fakultetin e Biznesit mbahet mësimi edhe në gjuhën boshnjake, por nuk di që sot dikush është paraqitur si boshnjak dhe ta ketë folur një fjali në gjuhën amtare. Porositi që edhe ky segment i shoqërisë të mos anashkalohet.

Branislav Grbiq tha kur flitet për integritime evropiane, varet më shumë nga ne se sa nga Evropa. Evropa, duke u mbështetur në angazhimin tuaj në punë dhe në fakultet, krijon klimë mirëbesimi për identifikimin e qytetarëve evropianë. Shtoi të gjithë dëshirojmë që ky proces të mos jetë shumë i shpejtë, sepse kemi përvojë të hidhur të Bullgarisë dhe të Rumanisë. Problemet më të mëdha tha janë papunësia dhe gjendja ekonomike, sepse integritimi është vetëm çështje kohe.

Engelber Zefaj njoftoi se ftesa u është shpërndarë të gjitha institucioneve dhe ato kanë të drejtë të zgjedhin. Garantoj se në Këshillin Rinor janë përfshirë të gjithë përfaqësuesit, pa marrë parasysh fenë, gjuhën dhe kombin.

Njomza Emiri tha meqë jemi shoqëri me moshë shumë të re dhe e dimë gjendjen e përgjithshme në Kosovë dhe sfidat tona, duhet secili të fillojë nga vetja që t'i plotësojmë standardet. Kjo do të ishte më e mira. Inkurajoj nismën e të rinjve që të informohen për rolin dhe fushëveprimin e Komisionit. Shtoi se nuk ka informim të shoqërisë për procesin e integritimeve.

Hydajet Hyseni përshëndeti praninë e të rinjve. Dhe tha do të mësojmë nga përvoja juaj. Edhe sikur të mos e kishim kërkesën për anëtarësim, kjo do të duhej të ishte aspiratë thelbësore. Është tani një debat për Kodikën e Beratit, i cili paraqet një dokumente shumë të hershëm të civilizimit. Ne ende nuk i kemi zbuluar këto vlera, sepse puna ishte ndërprerë. Të vazhdojmë t'i kërkojmë këto vlera në proceset aktuale është shumë e rëndësishme. Tha më bëri përshtypje fjalia në të cilën thuhej se nuk është instaluar demokracia në institucionet e Kosovës dhe se kjo është pengesë kryesore që nuk po integrohemi në BE. Shtoi çështja nuk është aq e thjeshtë, sepse institucionet e Kosovës nuk janë të demokratizuara më pak sesa institucionet e shumë vendeve të tjera. Problemi qëndron në atë se nuk i kemi afirmuar ato. Njoftoi se Kuvendi ka rol inicimit e jo ekzekutimi, andaj do të ishte mirë të diskutoni me përfaqësuesit që merren me integritet dhe që drejtpërdrejt janë të angazhuar në këtë proces. Anëtarësimi në BE ka kosto të lartë. Dëshmi për këtë është nënshkrimi i CEFT-ës. Përfaqësuesit tanë kanë qenë të entuziazuar se po na ftojnë dhe kanë nënshkruar gjithçka, përderisa vendet e tjera nënshkruanë kishin avantazhe, Kosova kishte vetëm humbje, sepse hymë pa dinjitet dhe të paorganizuar. Në gjithë procesin na duhet qasje më kërkuese. Propozoj fokusimin më të madh të kësaj organizate në çështjet rinore, sepse janë lënë pak anash.

Naser Lajqi tha do të ishte mirë të vini tek ne, por jo vetëm para zgjedhjeve. Shtoi po përpigemi të bëjmë diçka, por jemi të kufizuar për shkak të buxhetit. Sa i përket liberalizimit të vizave, tha kemi dëgjuar se një gjë e tillë do të bëhet në të ardhmen. Kur do të jetë kjo e ardhme? Sa ka bërë shteti i Kosovës për integrimin e komuniteteve në shoqërinë kosovare?

Zylfije Hundozi tha kam marrë dokumentin e fundit, në të cilin ishin të përfshira shtetet e Ballkanit Perëndimor, por jo edhe Kosova. Edhe në këtë dokument kushtet që shtetet duhet t'i përmbushin për liberalizimin e vizave janë: pasaportat biometrike, eliminimi i krimi të organizuar dhe korrupsioni, menaxhimi i integruar i kufijve.

Dzezair Murati tha Republika e Kosovës legjislacionin e ka hartuar në bazë të dokumentit të Ahtisarit. I vetmi zë kundër Planit të Ahtisarit ka ardhur nga rajoni i Pejës, nga komuniteti im. Legjislacionin e kemi miratuar me procedurë të shpejtë. Ai mbështetet në Pakon e Ahtisarit dhe në ligjet e tjera të miratuara me procedurë të rregullt. Shtoi ekzistojnë mekanizma efikas për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve që ne i shfrytëzojmë. Sa i përket zbatimit të ligjeve kemi vështirësi. Kjo shkon më ngadalë, sepse gjyqësia ende nuk është në nivelin e duhur.

Nimon Bica i kërkoi nga institucionet e Kosovës të angazhohen më shumë që ta kemi një studim të mirë të fizibilitetit.

Njomza Emini tha në Kuvendin e Kosovës është një grup joformal i të rinjve, i cili është i hapur për çdo kërkesë dhe propozim që vjen nga të rinjtë.

Kryesuesja - I falënderoi pjesëmarrësit për angazhimin dhe interesimin e tyre për punën e Komisionit.

3. Miratimi i rekomandimeve të dala nga tryeza e rrumbullakët

Rekomandimet e tryezës së rrumbullakët u miratuan pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen nga rrezatimi jojonizues, jonizues dhe siguria nukleare, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesja - I njoftoi anëtarët e Komisionit se Projektligjit për mbrojtjen nga rrezatimi jojonizues, jonizues dhe siguria nukleare, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nuk i cenon parimet e *Acquis Communautaire* dhe mund të procedohet tutje.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Projektligji për mbrojtjen nga rrezatimi jojonizues, jonizues dhe siguria nukleare, me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, nuk i cenon parimet themelore të Acquis Communautaire dhe politikat e BE-së.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për partneritetet publike-private dhe koncesionet e sigurimit të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike dhe procedurat për dhënien e tyre, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesja – E ftoi deputetin Naser Rugova ta paraqesë raportin lidhur me përputhshmërinë e Projektligjit me *Acquis Communautaire*.

Naser Rugova tha është një ligj shumë i rëndësishëm, i cili nuk i cenon parimet e *Acquis Communautaire*, andaj propozoj që ky projektligj të procedohet tutje.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Projektligji për partneritetet publike-private dhe koncesionet e sigurimit e infrastrukturës dhe të shërbimeve publike dhe procedurat për dhënien e tyre, me amendamente të Komisionit Funkcional, nuk i cenon parimet themelore të Acquis Communautaire dhe politikat e BE-së.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për Protokollin shtetëror të Republikës së Kosovës me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesja e ftoi deputeten Njomza Emini ta paraqesë raportin për Projektligjin për Protokollin shtetëror të Republikës së Kosovës.

Njomza Emini tha Protokollin i shteti nuk është i rregulluar me *Acquis Communautaire* dhe i është lënë hapësirë secilit shtet ta rregullojë këtë sipas së drejtës së tij të brendshme.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Projektligji për Protokollin shtetëror të Republikës së Kosovës, me amendamente të Komisionit Funkcional, nuk i cenon parimet themelore të Acquis Communautaire dhe politikat e BE-së.

7. Të ndryshme

a) Ftesë për të marrë pjesë në seminarin e organizuar nga DICAFA-i në Ohër

Kryesuesja - I njoftoi anëtarët e Komisionit për ftesën e organizatës DICAFA, që një anëtar i Komisionit të marrë pjesë në seminarin njëditor që organizohet në Ohër.

Pas diskutimeve të deputetëve u nxor ky

Përfundim

Deputeti Fatmir Rexhepi do të marrë pjesë në seminarin njëditor të organizuar nga organizata DICAF, në Oher.

b) Organizimi i vizitave të komisioneve

Nait Hasani kërkoi të ketë agjendë përkatëse për realizimin e vizitave jashtë vendit dhe për pritjen e delegacioneve. Për këtë tha duhet të angazhohen organizatat të cilat e mbështesin Komisionin.

Kryesuesja - Njoftoi se në takimin, të cilin do ta mbajë me përfaqësues të Komisionit Evropian, do të kërkojë t'i organizojnë dhe t'i financojnë dy takime, sepse kanë premtuar për këtë. OSBE-ja ka premtuar se do të na e mundësojë një vizitë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20 min.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Zylfije Hundozi